



REPUBLIKA E SHQIPERISË
MINISTRIA E TURIZMIT DHE MJEDISIT
AGJENCIA KOMBËTARE E MJEDISIT
DREJTORIA E LEJEVE MJEDSIORRE DHE VNM

AN270620230002

Tiranë, më 01.08.2023

Komisioni 83

DEKLARATË MJEDISORE

Në mbështetje të Ligjit Nr. 12/2015 “Për disa ndryshime në ligjin nr. 10440, datë: 07.07.2011, “Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis”, VKM 714, datë: 06.11.2019, për disa ndryshime dhe shtesa në VKM 686, datë: 29.07.2015, “Për miratimin e rregullave, përgjegjesive e afateve, për zhvillimin e procedurës së transferimit të Vendimit e Deklaratës Mjedisore”, të ndryshuar, dhe me propozim të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, Ministri

VENDOSI:

Lëshimin e Deklaratës Mjedisore për **Zhvilluesin** me të dhënat si më poshtë:

Personi juridik: “SHIJAKU Sh.p.k

Nr. NIPT-i: J64102272V

Adresa e selisë: Rruga Kombëtare Fushë Krujë - Vorë, km.1, në anën e majtë, pranë mbikalimit Fushë Krujë, numër pasurie 325/34, Zona Kadastrale 1042, Fushë Krujë.

Personi përgjegjës: Shpëtim Shijaku

Për të zhvilluar projektin “**Shfrytëzimi i gurit gëlqerore dhe përpunimi i gurit në impiantin e fraksionimit, Zona Minerare Nr. 253/6, objekti i gurit gëlqeror "Kodra e Kojlikës”, Qarku Durrës.**”

Aplikimi është bërë referuar ligjit Nr. 10 440, date: 7.7.2011 “Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis”, Shtojca I, “Projektet që i nënshtrohen Procedurës së Thelluar të Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis”, Pika 19. Gurore dhe miniera sipërfaqësore, ku sipërfaqja e vendit është mbi 0,5 hektarë, ose vende për nxjerrjen e torfës, ku sipërfaqja e vendit është mbi 1 hektar.

Vendndodhja: Zonë Minerare 253/6, objekti i gurit gëlqeror "Kodra e Kojlikës”, Qarku Durrës.

Të dhëna teknike:

Sipërfaqe sipas MIE: 0.346 km²

Lloji i mineralit: *gur gëlqeror*

(Bashkangjitur vendimit, gjeni aneksin me hartën topografike dhe koordinatat metrike, ku tregohet vendodhja e objektit).

Bazuar në nenin 12, të ligjit nr. 10440, datë 7.7.2011, “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis”, i ndryshuar, i sugjerohet autoritetit planifikues:

Miratimi i lejes/licencës së zhvillimit të atij projekti, me kushtet që duhet të përmbushen nga zhvilluesi, për të parandaluar, minimizuar dhe menaxhuar ndikimet negative në mjedis;

Bazuar në pikën 2, të nenit 12, të ligjit nr. 10440, datë 7.7.2011, “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis”, të ndryshuar, më poshtë po listojmë:

1. Qëndrimin e Ministrisë dhe sipas rastit, kushtet që duhet të përmbushen nga zhvilluesi:

Drejtoritë Teknike të Ministrisë shprehën: o Sugjerojmë që gjatë zbatimit të projektit, mbetjet e gjeneruara të menaxhohen sipas kuadrit ligjor si më poshtë:

- Të zbatohet Ligji nr. 10 463, date 22.09.2011, “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, të ndryshuar;
- Të respektohen kërkesat e Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 418, date 25.06.2014, “Për grumbullimin e diferencuar të mbetjeve në burim”;
- Mbetjet që do të krijohen, të specifikohen sipas kodeve të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 402, datë 30.06.2021 “Për miratimin e katalogut të mbetjeve”;
- Transferimi i mbetjeve jo të rrezikshme të shoqërohet me plotësimin e shtojcës 1 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 229, datë 23.04.2014, “Për miratimin e rregullave për transferimin e mbetjeve jo të rrezikshme dhe të dokumentit të transferimit të mbetjeve jo të rrezikshme”, të ndryshuar;
- Mbetjet e rrezikshme, të dorëzohen sipas Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 371, datë 11.06.2014 “Për përcaktimin e rregullave për dorëzimin e mbetjeve të rrezikshme dhe miratimin e dokumentit të dorëzimit të mbetjeve të rrezikshme”, të ndryshuar;
- Subjekti që do të transportojë ose do të transferojë mbetjet të jetë i pajisur me licensë III.2.B , si detyrim i nenit 57, të ligjit nr. 10463, date 22.09.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve“ i ndryshuar;
- Gjatë fazës ndërtimore mbetjet inerte të gjeneruara të trajtohen sipas kërkesave të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 575, datë 24. 06. 2015 “Për miratimin e kërkesave për menaxhimin e mbetjeve inerte”.

Në raport citohet VKM nr.175, datë 19.1.2011 “Për miratimin e strategjisë kombëtare të menaxhimit të mbetjeve dhe të planit kombëtar të menaxhimit të mbetjeve”, i cili është shfuqizuar;

- Për të gjitha mbetjet nga ambalazhet të zbatohet Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 177, datë 06.03.2012, “Për ambalazhet dhe mbetjet e tyre”, i ndryshuar. Në veprimtarinë për të cilën aplikon subjekti, menaxhimi i mbetjeve të bëhet sipas Parimit të Përgjegjshmërisë Ndaj Mjedisit, në përputhje të plotë me VKM nr. 418, datë 27.5.2020 “Për miratimin e Dokumentit të Politikave Strategjike dhe të Planit Kombëtar për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve, 2020-2035”, duke synuar uljen e sasisë së mbetjeve të gjeneruara dhe menaxhimin në mënyrë të integruar të mbetjeve. o Me qëllim mbrojtjen e cilësisë së ajrit në mjedis dhe në zbatim të legjislacionit përkatës për këtë fushë, sugjerohet që gjatë fazës së shfrytëzimit, duhet të mbahen në konsideratë rekomandimet e mëposhtme:

- Të respektohen normat e lejuara të shkarkimeve në ajër të ndotësve të gaztë dhe lëndës së ngurtë pezull, në zbatim të VKM-së nr. 435, datë 12.9.2002 “Për miratimin e normave të shkarkimeve në ajër në Republikën e Shqipërisë”;
- Të spërkaten rregullisht me ujë rrugët e transportit, për mbajtjen nën kontroll të pluhurformimit, si dhe forcimin e zbatimit të këtyre masave edhe më shumë në kohën e thatë dhe me erë, në zbatim të VKM-së nr. 412, datë 19.6.2019 “Për miratimin e planit kombëtar për menaxhimin e cilësisë së ajrit”;

- Automjetet transportuese, të mos ngarkohen më shumë së kapaciteti i tyre mbajtës, si dhe të mbulohen me struktura të posaçme, për të shmangur përhapjen e pluhurave dhe derdhjen e materialeve që transportohen, në zbatim të VKM-së nr. 412, datë 19.6.2019 “Për miratimin e planit kombëtar për menaxhimin e cilësisë së ajrit”;

- Me qëllim mbrojtjen e mjedisit, përdorimi i lëndëve plasëse, të bëhet në përputhje me Ligjin nr. 74/2021 “Për hedhjen në treg dhe mbikëqyrjen e lëndëve plasëse për përdorim civil”.

o Në zbatim të legjislacionit përkatës për fushën e ndryshimeve klimatike, sugjerohet që të kryhet rehabilitimi i plotë i sipërfaqeve të gjelbra të dëmtuara si rezultat i ushtrimit të aktivitetit.

o *Drejtoria e Natyrës dhe Pyjeve* shprehet si më poshtë”

- *Spektori i pyjeve*: Vlerësojnë se e baza ligjore për Sektorin e Pyjeve është e gabuar.

Meqë sipërfaqja sipas lejes së shfrytëzimit është e madhe duhet që ndërhyrja të bëhet sipas një grafiku me sipërfaqe të vogla sipërfaqjet që do përdoren për projektin me funksion pyll, në çdo rast duhet të kihet parasysh zbatimi me rigorizitet i ligjit 57/2020, datë 30.4.2020 “Për pyjet” në mënyrë të veçantë neni 12, i tij të realizojë rehabilitimin menjëherë pasi të mbarojnë punimet në këto sipërfaqe, sipas grafikut të ndërhyrjes.

- *Spektori i mbrojtjes së natyrës*: Sugjeron që subjekti gjatë zhvillimit të aktivitetit duhet ti përmbahet legjislacionit në fuqi për mbrojtjen e natyrës dhe konkretisht ligjeve:

- Ligjin nr. 9587, datë 20.7.2006 “Për mbrojtjen e biodiversitetit” i ndryshuar;

- Ligjin nr.10 006, datë 23.10.2008 “Për mbrojtjen e faunës së egër” i ndryshuar, si dhe të bëjë rehabilitimin e zonës me mbjellje pemësh.

o Sugjerojmë verifikimin nga ana juaj të vlefshmërisë së procesit të realizuar të konsultimit me publikun mbi respektimin e parashikimeve në VKM nr.247 datë 30.04.2014 “Për përcaktimin e rregullave, të kërkesave e të procedurave për informimin dhe përfshirjen e publikut në vendimmarrjen mjedisore” në lidhje me afatet ligjore dhe përcaktimet e tjera. Bazuar në nenin 12, pika 1 e ligjit nr.10440/2011 “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis” të ndryshuar, në rast se zgjidhni pikën “a” apo “b” të referencës ligjore së sipërcituar, në Deklaratën Mjedisore të vendosen kushte të detajuara përsa i përket mbrojtjes së biodiversitetit, menaxhimit të pyjeve, emetimeve në ajër, shkarkimeve të ujrave të ndotura, menaxhimit të mbetjeve etj., të cilat duhet të përmbushen nga zhvilluesi, për të parandaluar, minimizuar dhe menaxhuar ndikimet negative në mjedis.

Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura shprehet: Bazuar në planvendosjen dhe koordinatat e aplikimit, sipërfaqja ku do të zhvillohet aktiviteti “Shfrytëzimi i mineralit gur gëlqeror, nr. 253/6, objekti “Kodra e Kojlikës”, Qarku Durrës, me zhvillues dhe aplikues “SHIJAKU”, me nr. Aplikimi AN270620230002, nuk ndodhet brenda rrjetit të zonave të mbrojtura.

Agjencia Rajonale e Mjedisit Pas shqyrtimit të dosjes së VNM së paraqitur nga zhvilluesi “SHIJAKU GROUP”Sh.p.k, për veprimtarinë “Shfrytëzim i mineralit të gurit gëlqeror. Përpunim i gurit në impiant thyerje.”, me vendndodhje në Durrës, Krujë, Kodra e Kojlikes, Zona nr.253/6, Agjencia Rajonale e Mjedisit Tiranë, Durrës, Dibër, shprehet se shfrytëzimi i mineralit të gurit gëlqeror është një aktivitet me pasoja negative për mjedisin duke qënë se shkakton degradim, copëtim dhe humbje të habitateve natyrore, si dhe nxit erozionin e terrenit kodrinor. ARM Tiranë, Durrës, Dibër sugjeron marrjen e të gjitha masave të nevojshme për parandalimin dhe minimizimin e ndikimeve negative në mjedis, si dhe rehabilitimin e plote të habitatit.

Sugjerojmë: - Kamionat transportues të gurit gëlqeror të jenë të pajisura me bordura mbrojtëse dhe me mushama për të shmangur rënien aksidentale të gurit dhe përhapjen e pluhurave. Të pastrohen gomat e makinave kur të dalin nga territori.

- Të zbatohen standardet dhe praktikatat më të mira gjatë përdorimit të lëndëve plasëse. Punëtorët të pajisen me kufje për mbrojtjen nga zhurma.

- Të përdoren sprucator për të shmangur përhapjen e grimcave të pluhurave si pasoje e shperthimeve gjate shfrytëzimit të gurit gelqeror.
- Të bëhet trajtimi i ujërave të ndotur me grope dekantimi.
- Gjatë hapjeve të rrugeve të reja subjekti të kete kujdes bimesine ne zonen ku do te nderhyje, duke pasur parasysh se në çdo rast te prerjeve apo shkuljeve te pemeve, gjate fazes se rehabilitimit ato te zevendesohen me po te njejtat lloj.
- Të parashikohen masat për parandalimin dhe shuarjen e zjarreve në rast aksidentesh.
- Të zbatohet orari sipas legjislacionit në fuqi per levizjen e automjeteve, per te shmangur vibrimet dhe zhurmat ne zonat e banuara.
- Në të gjitha rastet që do të ketë ndërhyrje në mjedis do të duhet të ruhet vegjetacioni si edhe bimësia karakteristike zonale duke mos dëmtuar në asnjë rast peizazhin natyror të zonës së marrë në studim.
- Ne rastet se gjate venies ne zbatim te projektit dhe funksionimit te tij do te verehet prania e flores dhe e faunes te cilat jane specie te rrezikuara ose endemike te tregohet kujdes i vecante per te mos e demtuar ate.
- I gjithë territori i shfrytëzimit te rrethohet me rrjete per te parandaluar hyrjen e kafsheve te zones.

Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë: Miratim ne heshtje.

2. Informacion për procesin e realizuar të konsultimit me publikun:

Konsultimi me publikun: U krye në datën 21.05.2023. Morën pjesë përfaqësues nga komuniteti i zonës, përfaqësues nga Pushteti Vendor si dhe nga Agjencia Rajonale e Mjedisit dhe përfaqësues nga studio mjedisore. Në takim është prezantuar projekti, janë dëgjuar sugjerimet e pjesëmarrësve, të cilat do të merren parasysh nga ana e investitorëve, gjatë kohës së shfrytëzimit. Nga ana e investitoreve iu siguria të pranishmeve që do të merren të gjitha masat për eliminimin e ndikimeve negative në mjedis, duke mos cënuar jetën e banorëve. Kërkesat e pjesëmarrësve, do të mbahen parasysh, në fazën kur shoqëria do të fillojë procedurat për fazën e shfrytëzimit.

3. Arsyet dhe konsideratat kryesore, ku është mbështetur mendimi;

Zhvillimi i aktivitetit është në përputhje me:

- Në mendimin e anëtarëve të Komisionit 83, datë 31.07.2023, i mbledhur në zbatim të Urdhërin nr.75, datë 07.04.2023, për “Krijimin e komisionit teknik për shqyrtimin e kërkesave që i nënshtrohen procedurës paraprake dhe të thelluar të vlerësimit të ndikimit në mjedis”;
- Njoftimin për fillim procedure për zonën nr.2830/1, datë 17.03.2023, nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë.
- Mendimin e Agjencisë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura;
- Mendimin e Agjencisë Rajonale të Mjedisit.

4. Përshkrimin, sipas rastit, të masave kryesore që duhen marrë për të shmangur, reduktuar e nëse është e mundur, për të korrigjuar efektet negative të rëndësishme:

4.1 Ky objekt të ndërtohet në përputhje të plotë me Planin e Përgjithshëm Vendor dhe Planin e Detajuar Vendor, të miratuar nga organet kompetente (KKT / Bashkia / Njësi Administrative) dhe akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi.

4.2 Ky vendim nuk është leje zhvillimi përfundimtare për zbatimin e këtij projekti, por është një dokument i cili lëshohet me kusht që në rast se do të zhvillohet ky aktivitet, duhet të zbatohet kushtet e vendosura si detyrim që vjen nga Ligji Nr. 10431, datë 9.6.2011 “Për Mbrojtjen e

Mjedisit”, si dhe Ligji nr. 10 440, datë 07.07.2011 “Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis”, të ndryshuar, KREU I, Neni 1, Pika a); KREU II, Neni 7, Pika 1; KREU V, Neni 20, Pika 1.

- 4.3 Në rast se gjatë punimeve shfaqen elemente të tillë si: objekte kulturi, gjurmë arkeologjike, burime ujore etj, subjekti të ndërpresë punimet dhe të lajmërojë urgjentisht organet kompetente.
- 4.4 **Kjo Deklaratë është e vlefshme pasi subjekti të bëjë heqjen nga Fondi Pyjor, në rast se aktiviteti bie në një të tillë.** Të ketë në vëmendje të veçantë referencat kadastrale që preken nga ushtrimi i aktivitetit.
- 4.5 Në bazë të Ligjit Nr. 81/2017, “Për Zonat e Mbrojtura”, nga zbatuesit e projektit të merren masa që mos të dëmtohen zona me status të vecantë.

Gjatë fazës së instalimit:

- 4.6 Të vendoset sinjalistika paralajmëruese përgjatë gjithë segmentit të punimeve me qëllim shmangien e aksidenteve njerëzore.
- 4.7 Të instalohet sistemi i eliminimit dhe kapjes së pluhurave, nëpërmjet sprucimit me ujë. (Ky sistem, të detajohet qartë me skica, planimetri etj në aplikimin për Leje Mjedisore)
- 4.8 Të kontrollohen kushtet teknike të mjeteve të punës në mënyrë periodike për të evituar, parandaluar rrjedhjet e lubrifikantëve e të hidrokarbureve në mjedis, emetimin e gazeve të shkaktuara nga avari teknike të mjeteve të subjektit.
- 4.9 Të respektohet distanca nga rruga, gjatë fazës së instalimit dhe kryerjes së punimeve, sipas legjislacionit në fuqi.
- 4.10 Përdorimi i pajisjeve, automjetet, që emetojnë nivele zhurmash brenda normave të lejuara të emetimit 60 – 100 db.
- 4.11 Subjekti të realizojë në mënyrë të menjëhershme çdo ndërhyrje teknike për të riparuar çdo fenomen negativ në mjedis si pasojë e veprimtarisë së tij.
- 4.12 Të sistemohen brenda sipërfaqes së shfrytëzimit të gjitha sterilet e gjeneruara nga shfrytëzimi i karrierës.
- 4.13 Në raste aksidentesh ose defektesh teknologjike që shkaktojnë ndotje të mjedisit, subjekti menjëherë duhet të jap informacion në DRM-në e qarkut përkatës dhe AKM, të cilat bëjnë të mundur njoftimin e popullatës që preket nga ky aksident.
- 4.14 **Subjekti të hartojë dhe zbatojë një plan masash lidhur me masat e parandalimit dhe shuarjen e zjarreve në rast aksidentesh nga plasjet për nxjerrjen e materialit.**
- 4.15 Të mbillen pemë në të gjithë perimetrin e zonës për të minimizuar ndikimet në mjedis dhe përmirësuar pejsazhin.
- 4.16 Subjekti të kujdeset për menaxhimin e mbetjeve të krijuara gjatë fazës së instalimit, sidomos ato të ambalazhimit, duke i transportuar në mënyrë të rregullt në vend grumbullimit e caktura nga njësia vendore. Zotëruesit e mbetjeve inerte duhet të zbatojnë detyrimet që janë të përcaktuara në VKM nr.575, datë 24.06.2015 “Për miratimin e kërkesave për menaxhimin e mbetjeve inerte”.
- 4.17 Përgjatë gjithë rrugës së brendshme të karrierës (përfshi transhetë), të hapet një kanal ujëmbledhës i orientuar drejt një grope dekantimi, për mbledhjen dhe disiplinimin e ujërave gjatë kohës së shfrytëzimit.
- 4.18 Të bëhet pastrimi i mjeteve të punës para daljes nga kantieri i ndërtimit për të mos shkakuar ndotje në mjedis.
- 4.19 Të merren masa për mbrojtjen e biodiversitetit të zonës.
- 4.20 **Të kihet kujdes treguesit kadastralë të sipërfaqes pyjore/kullosore që do të përdoret për aktivitetin, të jenë vetëm brenda sipërfaqes së miratuar.**

- 4.21 Personi përgjegjes teknik për zhvillimin e aktivitetit duhet të jetë i informuar për bazën ligjore të pyjeve në fuqi dhe për zbatimin e tyre.**
- 4.22** Subjekti të respektojë kushtet lidhur me mbrojtjen e biodiversitetit, menaxhimin e pyjeve, emetimet në ajër, shkarkimet e ujërave të ndotura, menaxhimin e mbetjeve etj.
- 4.23** Subjekti të respektojë dhe të mbajë parasysh kërkesat dhe kriteret e Ligjit Nr. 81/2017 “Për Zonat e Mbrojtura”.
- 4.24** Kompania duhet të respektojë gjithashtu kushtet e vendosura në raportin e VNM-së të aplikuar si dhe Ligjin Nr. 10 431, datë 9.6.2011 “Për Mbrojtjen e Mjedisit”.
- 4.25** Në përfundim të punimeve, të rehabilitohet zona e shfrytëzuar.
- 4.26 Duke qënë se gjatë fazës së funksionimit, ky aktivitet do të ketë efekte në mjedis, në bazë të Ligjit Ligj nr. 52/2020, datë 30.4.2020 “Për disa ndryshime në ligjin nr. 10 448, datë 14.7.2011, “Për lejet e mjedisit”, të ndryshuar.**

5. Monitorimi dhe Raportimi

Në bazë të Ligjit Nr. 128/2020 Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin Nr. 10440, datë: 07.07.2011, “Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis”, të ndryshuar, Neni 25/1 “Monitorimi dhe vlefshmëria”, zhvilluesi ka detyrimet si më poshtë:

- Zhurma dhe Vibracionet

- Të zbatohen nivelet kufi të zhurmës, referuar Udhëzimit Nr. 8, date 27.11.2007 “Për nivelet kufi të zhurmave në mjedise të caktuara” dhe Ligjit Nr.9774 date 12.07.2007 “Për vlerësimin dhe administrimin e zhurmës në mjedis”
- Të merren masa për mbrojtjen e punonjësve nga zhurmat.
- Të merren masat për kufizimin e orareve të punës në kantier.
- Operatori duhet të parandalojë gjenerimin e zhurmës impulsive në zonat e ndjeshme ndaj zhurmës, gjatë operimit të instalimeve.
- Vibrimet në vende të ndjeshme nuk duhet të kalojë 10 mm/s (PPV) në çdo kohë.
- Të bëhet monitorimi i zhurmave për mjediset: automjete/kamiona në hyrje të kantierit, kantier ndërtimi dhe mjedisi urban më i afert me kantierin çdo 6 muaj.

Mjedisi	Vlera kufi e zhurmës dB(A) Leq, T Ditë	Vlera kufi e zhurmës dB(A) Leq, T Mbrëmje	Raportimi në AKM	Periodiciteti
Automjete/kamiona ne hyrje te kantierit	55	45	02.02.2024	Çdo 6 muaj
Kantier ndertimi	55	45	02.02.2024	Çdo 6 muaj
Mjedisi urban me i afert me kantierin	55	45	02.02.2024	Çdo 6 muaj

Tabela e niveleve kufi:

- Shkarkimet në Ajër

- Të zbatohen nivelet kufi të shkarkimeve në ajër, referuar Ligjit Nr. 162/2014 “Për Mbrojtjen e Cilësisë së Ajrit në Mjedis” dhe VKM Nr. 248, datë: 24.03.2003 “Për Miratimin e Normave të Përkohshme të Shkarkimeve në Ajër dhe Zbatimin e tyre”.
- Shkarkimet në ajër të jene brenda normave të lejuara, duke marre masa për reduktimin e tyre.
- Kantieri në të cilin emetohen lëndë grimcore në ajër, duhet të pajiset sipas mundësive teknike dhe mbi bazën e natyrës së procesit, me rrjeta uji / sisteme spërkatje / sisteme heqje pluhurash.
- Të bëhet monitorimi i nivelit të pluhurave në ajër, për mjediset: kantier ndërtimi dhe mjedisi urban më i afert me kantierin çdo 6 muaj.

Tabela e niveleve kufi

Ndotësi	Përqëndrimi	Raportimi në AKM	Periodiciteti
Lënda grimcore (PM _{2.5})	20-25 µg/m ³	02.02.2024	Çdo 6 muaj
PM ₁₀	50 µg/m ³ , 40 µg/m ³	02.02.2024	Çdo 6 muaj

- **Cilësia e ujrave**

Parametrat që duhet të monitorohen

Ndotësi	Përqëndrimi	Raportimi në AKM	Periodiciteti
Lëndët në pezulli	50 mg/l	02.02.2024	Çdo 6 muaj

- **Subjekti duhet të sjellë pranë AKM-së si më poshtë:**
- Informacion në momentin e fillimit të punimeve
- Raportimin periodik për parametrat që do të monitorohen sipas datës së raportimit/ çdo 6 muaj.
- Informacion në përfundim të punimeve, lidhur me punimet rehabilituese të territorit përreth, shoqëruar edhe me foto.

- **Afati i Vlefshmërisë**

- Vendimi për VNM-në paraprake për projektin e propozuar është e vlefshme për aq kohë sa është i vlefshëm edhe dokumenti i miratimit të zhvillimit për projektin.
- Nëse projekti, që i është nënshtruar procesit të VNM-së, nuk fillon zbatimin në terren brenda 2 vjetëve nga data e miratimit të deklaratës mjedisore apo të vendimit për VNM-në paraprake, atëherë këto dokumente konsiderohen të pavlefshme dhe procesi i VNM-së fillon nga e para.

Në bazë të udhëzimit të MM dhe MF nr. 7938, datë 17.7.2014 “Për përcaktimin e tarifave dhe vlerave përkatëse për shërbimet që kryen Ministria e Mjedisit për procesin e VNM-së”, ky subjekt ka kryer pagesën 50.000 lekë.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM

ARTA DOLLANI


MINISTRI

MIRELA KUMBARO FURXHI

Konceptoi:

Pranoi:

Aneksi 1. Harta me Koordinatat (sipas MIE)



Harta topografike e zones

Pika	Koordinata	
	Y	X
1	43 92 550	46 02 920
2	43 92 550	46 02 490
3	43 92 830	46 02 490
4	43 93 185	46 02 400
5	43 93 185	46 02 920